



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODOVOD I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



REPUBLIKA E KOSOVËS	KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE MBETURINA REGULATORNI URED ZA VODOVOD I OTPAD WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE	ZRRUM
Nr. prot. Prot. Br. Prot. No.	191
Udhëzimi	1
Nr. Protokoll. Udh. Prot. No.	10.04.2011
Dalja/Exit Date	
PRISHTINË - PRISTINA - PRISHTINA	

UA - 01/2011
06.04.2011

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina (në tekstin e mëtutjeshëm: "ZRRUM"),

Në pajtim me autoritetin e dhënë me Nenin 8.4 të Ligjit No. 03/L-086, Për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më datë 13 qershor 2008 (në tekstin e mëtutjeshëm: "Ligji"),

Pas konsultimeve me Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave që janë zhvilluar gjatë procesit të aprovimit të Buxhetit të ZRRUM për vitin 2011,

Me qëllim të përcaktimit të lartësisë së taksës së licencimit ose metodës së kalkulimit të kësaj takse që është e pagueshme sipas nenit 8 të Ligjit,

Me këtë nxjerrë Udhëzimin Administrativ si vijon:

Neni 1

Përkufizimet

1.1 Në këtë Udhëzim Administrativ:

"Ofrues i Shërbimeve" nënkupton Ofruesit e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave, Ofruesit e Shërbimeve të Deponimit të Mbeturinave, Ofruesit e Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit ose Furnizuesit e Ujit me Shumicë, krejt së bashku Ofrues të Shërbimeve, dhe në rast të bashkimit (shkrirjes) të ndonjë Ofruesi të Shërbimeve me një ose më tepër Ofrues të Shërbimeve, pasardhësin e tij.

1.2 Përveq nëse ndryshe është përkufizuar me këtë Udhëzim Administrativ, fjalët që fillojnë me shkronjë të madhe do ta kenë kuptimin e që iu është dhënë në Ligj.

Neni 2

Taksa e Aplikimit

Taksa e aplikimit për Licencë të Shërbimit e pagueshme nga një Ofrues i Shërbimeve sipas nenit 8.1 të Ligjit do të jetë €200.00.

Neni 3

Taksa Vjetore e Licencimit

- 3.3. Taksa vjetore e licencimit për vitin që fillon me 1 janar 2011 e pagueshme nga një Ofrues i Shërbimeve në pajtim me Nenin 8.2 të Ligjit do të jetë **0.89 %** të qarkullimit vjetor bruto të atij Ofruesi të Shërbimeve e që është vlera e dhënë në Shtojcën 3, e llogaritur në pajtim me Nenin 8.2 dhe 8.3 të Ligjit si vijon:

$$X = B \times t / T$$

Ku:

X = Vlera e Taksës Vjetore të Licencimit e pagueshme nga secili Ofrues i Shërbimeve

B = Shpenzimet e parapara të ZRRUM për vitin 2011 (shih Shtojcën 1)

t = Qarkullimi vjetor bruto i Ofruesit të Shërbimeve për vitin paraparak (shih Shtojcën 2)

T = Shuma e qarkullimit vjetor të të gjithë Ofruesve të Licencuar të Shërbimeve në vitin paraparak (shih Shtojcën 3)

- 3.4. Në rast se një Ofrues i Shërbimeve është bashkuar me një apo më tepër Ofrues të Shërbimeve, pasardhësi i tij duhet të paguajë taksën vjetore të licencimit që është e pagueshme nga Ofruesi i Shërbimeve që është bashkuar (shkrirë).

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ do të hyjë në fuqi më 1 prill 2011.



Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina